

VENDIM
Nr.72, datë 7.10.2008

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT
NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË BANKAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, të nenit 12, shkronja “a”, të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 57, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “b”, nenit 62, pika 2, shkronja “b”, dhe nenit 64 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, miratuar me vendimin nr. 31, datë 30.4.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja “e” e nenit 5, paragrafi (iii) dhe paragrafi (v) i shkronjës “b” të nenit 8, shfuqizohen.

2. Në nenin 7, shtohet pika 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Ekspozimi i bankës ndaj shoqërisë mëmë, filialit të bankës apo një ose më shumë filialeve të shoqërisë mëmë, nuk mund të tejkalojë 10 (dhjetë) për qind të kapitalit rregullator”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Statistikave për reflektimin e të gjitha ndryshimeve të nevojshme në formularët e raportimit (SRU), që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani